2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçensë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë (sipas legjislacionit në fuqi) për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Konstruktor/Strukturist
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik
- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Telekomunikacioni-IT / Elektronik i pajisur me certifikate në nivel profesional në networking, lëshuar nga CISCO, HUAWEI, FORTINET, PALO ALTO ose ekuivalent
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesipër, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen

dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Konstruktor është e nevojshme për shkak të natyrës së punimeve strukturore të parashikuara në objekt, të cilat përfshijnë ndërtimin e një godine të re me konstruksion mbajtës prej betoni të armuar, ndërhyrje në godinën ekzistuese dhe shtesën e saj me trajtimin e fugës strukturore ndërmjet tyre, si dhe realizimin e shkallëve metalike të emergjencës. Inxhinieri Konstruktor është i nevojshëm për ndjekjen dhe kontrollin teknik të zbatimit të elementeve mbajtëse, fugave, lidhjeve dhe strukturave metalike sipas projektit, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë strukturore të objektit.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Gjeoteknik është e nevojshme për shkak të karakteristikave të terrenit dhe natyrës së punimeve të parashikuara. Shkolla ndodhet në terren kodrinor me diferenca të konsiderueshme kuotash. Në zonën pas shkollës evidentohen shenja të lëvizjes dhe paqëndrueshmërisë së terrenit, ndaj projekti parashikon realizimin e mureve të reja mbajtëse prej betoni të armuar për stabilizimin dhe sistemin e kësaj zone. Duke qenë se punimet përfshijnë gjithashtu gërmime dhe realizimin e themeleve të godinës së re, prania e Inxhinierit Gjeoteknik është e nevojshme për vlerësimin e sjelljes së terrenit, kapacitetit mbajtës të tokës, kushteve të mbështetjes së themeleve dhe stabilitetit të skarpave dhe veprave mbajtëse, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së punimeve.

Kërkesa për disponimin e një Arkitekti është e nevojshme për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve arkitektonike të godinës së re dhe rikonstruksionit të godinës ekzistuese, përfshirë organizimin funksional të ambienteve, fasadat, rifiniturat dhe elementet e aksesueshmërisë, duke garantuar zbatimin në përputhje me projektin arkitektonik.

Ne lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Elektrik njesia e prokurimit mbanë në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkollës përfshin punime elektrike në një sasi të

konsiderueshme referuar projektit elektrik dhe eshte e nevojshme qe keto punime te kryhen nen kujdesin e Inxhinierit Elektrik.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projektin hidrosanitar, sistemin e kanalizimeve te KUZ dhe KUSH.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Mekanik është e nevojshme për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve të instalimeve mekanike, përfshirë sistemet e ngrohjes, ftohjes, ventilimit dhe mbrojtjes nga zjarri, duke garantuar zbatimin e tyre në përputhje me projektin teknik.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Telekomunikacioni/IT është e nevojshme për shkak të shtrirjes së sistemeve të komunikimit, teknologjisë së informacionit dhe sigurisë në disa godina dhe ambiente funksionale të kompleksit shkollor, përfshirë infrastrukturën e rrjetit dhe internetit, transmetimin e të dhënave, fibrën optike, sistemet CCTV, kontrollin e aksesit dhe sistemin e lajmërimit të zjarrit. Ndërlidhja dhe integrimi i këtyre sistemeve kërkon njohuri profesionale në konfigurimin dhe administrimin e rrjeteve IP, switching, routing dhe pajisjeve aktive të rrjetit, ndaj kërkohet që specialisti të jetë i certifikuar në Networking në nivel Professional nga CISCO, JUNIPER, HUAWEI, FORTINET, PALO ALTO ose ekuivalent

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Mjedisi është e nevojshme për ndjekjen dhe kontrollin e aspekteve mjedisore gjatë realizimit të punimeve, përfshirë menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, dherave dhe materialeve të dala nga gërmimet, kontrollin e pluhurave, zhurmave dhe ndotjeve të mundshme, si dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e tokës, ujërave dhe mjedisit përreth gjatë gjithë fazës së ndërtimit.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder është e nevojshme për kryerjen e matjeve dhe piketimeve gjatë zbatimit të punimeve, përcaktimin dhe kontrollin e kuotave, akseve dhe pozicionimit të godinave dhe elementeve të tjera të projektit, si dhe verifikimin gjeometrik të punimeve gjatë fazave të ndërtimit, duke garantuar zbatimin e tyre në përputhje me projektin.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf mbeshtetes për kryerjen e punimeve në objekt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Elektrik profili Automatizim
- 1 (nje) Inxhinier Gjeoinformatik
- 1 (nje) Arkitekt Peisazhi
- 1 (nje) Agronom

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesis e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa për staf inxhinierik mbështetës, përveç stafit teknik të përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë, është e nevojshme për shkak të kompleksitetit dhe shumëllojshmërisë së punimeve të parashikuara në objekt, të cilat përfshijnë sisteme dhe ndërhyrje të specializuara që kërkojnë njohuri të posaçme teknike. Ky staf do të mbështesë drejtuesit teknikë në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve specifike sipas profileve përkatëse, koordinimin ndërmjet disiplinave të ndryshme dhe zbatimin korrekt të zgjidhjeve teknike të parashikuara në projekt dhe preventiv.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Elektrik, profili Automatizim, është e nevojshme pasi në preventivin e punimeve parashikohet automatizimi, kontrolli dhe monitorimi i instalimeve teknike të objektit. Ky specialist është i nevojshëm për ndjekjen, konfigurimin dhe integrimin e sistemeve të automatizuara, përfshirë kontrollin e impianteve të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, si dhe ndërveprimin e tyre me sistemet elektrike dhe fotovoltaike, duke garantuar funksionimin e koordinuar dhe eficient të instalimeve.

Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Gjeoinformatik është e nevojshme për përpunimin, kontrollin dhe gjeoreferencimin e të dhënave hapësinore, koordinatave dhe matjeve të objektit gjatë zbatimit të punimeve. Duke qenë se ndërhyrjet realizohen në një kampus ekzistues dhe përfshijnë edhe ndërtime të reja, kontrolli i saktë i këtyre të dhënave është i rëndësishëm për respektimin e pozicionimit, gjurmës së ndërtimit, akseve, kuotave, kufijve dhe distancave ndërmjet objekteve sipas projektit dhe lejes së miratuar, duke reduktuar rrezikun e devijimeve gjatë piketimit dhe zbatimit. Gjithashtu, prania e këtij specialisti është e nevojshme për evidentimin, përpunimin dhe dokumentimin gjeohapësinor të rrjeteve infrastrukturore nëntokësore ekzistuese dhe të reja, përfshirë rrjetet elektrike, ujësjellësin, kanalizimet dhe telekomunikacionin, duke ndihmuar në shmangien e konflikteve me infrastrukturën ekzistuese gjatë punimeve. Përpunimi i këtyre të dhënave siguron njëkohësisht përgatitjen e saktë të dokumentacionit të gjendjes së realizuar (as-built) dhe përputhjen e tij me gjendjen faktike, projektin e miratuar dhe dokumentacionin teknik përkatës.

Kërkesa për disponimin e një Arkitekti Peizazhi është e nevojshme për shkak të punimeve të parashikuara për sistemimin e ambienteve të jashtme të kompleksit shkollor, ku përfshihen

sipërfaqe të gjelbra, mbjellje pemësh dhe shkurresh dekorative, ambiente sportive dhe rekreative, si dhe realizimi i kopshtit didaktik dhe serës mësimore. Prania e këtij specialisti është e nevojshme për ndjekjen e këtyre punimeve, organizimin e hapësirave të jashtme dhe përshtatjen e gjelbërimit me funksionet e ndryshme të tyre, në përputhje me projektin e parashikuar.

Kërkesa për disponimin e një Agronomi është e nevojshme për shkak të punimeve që lidhen me përgatitjen e tokës, mbjelljen dhe zhvillimin e bimësisë, si dhe ngritjen e serës mësimore dhe kopshtit didaktik. Ky specialist është i nevojshëm për përcaktimin e kushteve të përshtatshme të kultivimit, përgatitjen dhe përmirësimin e tokës dhe substrateve, mënyrën e mbjelljes, ujitjes, plehërimit dhe mirëmbajtjes së bimëve, si dhe për ndjekjen e zhvillimit të tyre pas mbjelljes, duke siguruar njëkohësisht funksionimin e serës dhe kopshtit si ambiente praktike për për njohjen, kultivimin dhe kujdesin ndaj bimëve nga nxënësit.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë *(nga Administratori i shoqërisë)* Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë inxhinier me përvojë pune dhe i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Shënim: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

2.3.9 Operatorët ekonomik duhet të ketë në staf, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, certifikate/diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, personelin si më poshtë:

- a) 1 (nje) Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin", Neni 49, pika 4.

- b) 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit të lëshuar nga Kryqi i Kuq, ose organe të licencuara/akredituara nga Republika e Shqipërisë.
- c) 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) 1 (një) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia për Eficencën e Energjisë në Ndertesa.
- e) 5 (pese) punonjës të pajisur me certifikatë : “Specialist për punimet në lartësi”, sipas V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- f) 1 (një) Koordinator Saldimi sipas standardit SSH EN ISO 14731 ose ekuivalent, lidhur me koordinimin dhe menaxhimin e proceseve të saldimit, i pajisur me certifikatën perkatese të lëshuar nga një trupe, e akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- g) 2 (dy) punonjës të certifikuar për punime speciale të saldimit sipas standardit EN ISO 9606-1:2017 ose ekuivalent, lëshuar nga një trupe, e akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- h) 1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve.

Per stafin e mesiperm, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emer/mbiemer, profili i punës, Diplomë / Certifikatë të vlefshme si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin.

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.

162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

Kërkesa për “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, është e lidhur me natyrën e kontratës dhe specifikat e saj, të cilat kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. **Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.** Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

Kërkesat e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”* si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 *“Për mbrojtjen e mjedisit”*. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë” dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

Kërkesa për disponimin e një Audituesi Energjetik në Ndërtesa, të certifikuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë në përputhje me VKM nr. 407, datë 19.06.2019, është e nevojshme për shkak të ndërhyrjeve të parashikuara për përmirësimin e performancës energjetike të objektit, të

cilat përfshijnë termoizolimimin e fasadave me sistem kapotë, dyert dhe dritaret me performancë të përmirësuar termike, sistemet e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, automatizimin dhe kontrollin e tyre, si dhe instalimin e impiantit fotovoltaik për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme. Prania e këtij specialisti është e nevojshme për vlerësimin e ndikimit të këtyre ndërhyrjeve në reduktimin e humbjeve termike, konsumin dhe performancën e përgjithshme energjetike të ndërtesës, si dhe për verifikimin e masave të parashikuara për rritjen e efikasitetit të energjisë.

Kërkesa për disponimin e punonjësve të trajnuar për punime në lartësi është e nevojshme për shkak të punimeve të parashikuara në fasada, çati dhe tarraca, si dhe gjatë montimit të shkallëve metalike të emergjencës, elementeve hijezuese dhe instalimeve të tjera në kuota të ngritura. Natyra e këtyre punimeve paraqet rrezik për rënie nga lartësia dhe kërkon personel të trajnuar për zbatimin e masave të mbrojtjes dhe përdorimin e sigurt të pajisjeve përkatëse, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, e ndryshuar.

Kërkesa për disponimin e një Koordinatori Saldimi sipas EN ISO 14731 është e nevojshme për shkak të punimeve të parashikuara për fabrikimin dhe montimin e konstruksioneve dhe elementeve metalike, përfshirë shkallët e emergjencës, elementet metalike hijezuese dhe punime të tjera që përfshijnë procese saldimi. Prania e këtij specialisti është e nevojshme për koordinimin dhe mbikëqyrjen teknike të proceseve të saldimit, kontrollin e procedurave, materialeve dhe personelit saldator, si dhe për sigurimin e cilësisë dhe konformitetit të lidhjeve të salduara në përputhje me kërkesat e EN ISO 14731.

Kërkesa për disponimin e saldatorëve të kualifikuar sipas EN ISO 9606-1 është e nevojshme për shkak të punimeve të parashikuara për fabrikimin dhe montimin e konstruksioneve dhe elementeve prej çeliku, përfshirë shkallët metalike të emergjencës, elementet hijezuese dhe punime të tjera që kërkojnë realizimin e lidhjeve me saldim. Duke qenë se cilësia e këtyre lidhjeve ndikon drejtpërdrejt në rezistencën dhe sigurinë e elementeve të realizuara, kërkohet që proceset e saldimit të kryhen nga personel me aftësi të provuara dhe të kualifikuar sipas EN ISO 9606-1.

Kërkesa për disponimin e një Specialisti për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit / Inxhinieri Materialeve është e nevojshme për shkak të shumëllojshmërisë së materialeve dhe produkteve që do të inkorporohen në objekt dhe kërkesave teknike të përcaktuara për performancën e tyre. Ky specialist është i nevojshëm për kontrollin dhe vlerësimin e karakteristikave teknike të materialeve, dokumentacionit të performancës dhe konformitetit, raporteve të testimit dhe rezultateve të provave, me qëllim verifikimin që materialet dhe produktet e përdorura plotësojnë kërkesat e projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve përkatëse.

2.3.10 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga

institucionet të llicencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, personelin si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	Numri i punonjësve
1	Teknik Ndërtimi	2 (dy)
2	Teknik Mekanik	1 (një)
3	Teknik Elektrik	1 (një)
4	Teknik Elektronik / IT	1 (një)
5	Teknik Gjeometer / Topograf	1 (një)
6	Elektricitë	4 (katër)
7	Instalues Panelesh Diellore/Fotovoltaike	2 (dy)
8	Hidraulikë	2 (dy)
9	Punonjes per instalime ngrohje-ftohje	2 (dy)
10	Karpentier	4 (katër)
11	Hekurkthyes	4 (katër)
13	Betonues	5 (pesë)
14	Suvatues/Murator	7 (shtatë)
15	Punonjes për veshje fasade	5(pesë)
16	Pllakashtrues	4 (katër)
17	Punonjes Parketi	2 (dy)
18	Bojaxhi	3 (tre)
19	Punonjes Duralumini	2 (dy)
20	Punonjes Gipsi	4 (katër)
21	Saldator	3(tre)
22	Përgatites konstruksione metalike	2 (dy)
23	Hidroizolues	2 (dy)
24	Marangoz/mobilier	2 (dy)
25	Manovrator	3 (tre)
26	Shoferi	3 (tre)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve për çdo kategori të mesipërme.

(Në rastin kur makineritë disponohen me qera për shoferët dhe manovratorët nuk kërkohet disponimi i tyre në listpagesat e shoqërisë, pasi këto punonjës mund të kontraktohen.)

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) që nuk janë leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të

metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

- Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emri i Mbiemri i punonjesit	Profesioni i punonjesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
...					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cilat duhet te dorezohen ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperme, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje)

Shënimi:*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar

për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”*. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit.

Tekniku i Mesëm Ndërtimit 2(dy) është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. Duke qënë se godina e re zë një volum të madh punimesh afërsisht 362.5 m² një kat, dhe shkolla po ashtu njësi e prokurimit gjykon se disponimi i 2 (dy) punonjësi të tilla garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve në kohë dhe me cilësi.

Teknik Mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të instalimeve hidro-sanitare dhe ngrohje, sipas zërave të preventivave të punimeve. Duke qënë se godina e re ka vetëm punime për sistemin e ngrohjes/ftohjes, njësi e prokurimit gjykon se disponimi i 1 punonjësi të tilla garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve në kohë dhe me cilësi.

Teknik i Mesëm Elektrik 1 (një) janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike meqëse palestra dhe shkolla janë dy objekte të pavarura nga njëra tjetra, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.

Teknik/gjeometer/topograf 1 (një) janë të nevojshëm për matjet në terren, për vendosjen e pikave të ndërtimit në baze të projekti dhe të bëjnë kontrollin e saktësisë së punimeve ndërtimore meqëse kryesisht palestra.

Tekniku IT/Elektronik 1 (një) janë të nevojshëm nevojshme për shkak të punimeve të parashikuara për instalimin dhe vënien në funksion të sistemeve të teknologjisë dhe rrymave të dobëta, përfshirë rrjetin e internetit dhe transmetimit të të dhënave, pajisjet aktive të rrjetit, sistemin CCTV, kontrollin e aksesit dhe sistemin e lajmërimit të zjarrit. Prania e këtij specialisti është e nevojshme për montimin, lidhjen, konfigurimin dhe testimin e pajisjeve dhe komponentëve elektronikë, si dhe për evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave teknike gjatë instalimit dhe vënies në punë të sistemeve.

Elektricitist 4 (kater) janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet për sistemin elektrike do të fillojnë të kryhen në muajin e dytë (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish elektrik.

Konkretisht, vetëm për punime elektrike janë parashikuar 7861.58orë punë nga zërat e instalimeve për ndricim për të vazhduar me tej tek analizat jashtë liste tek preventivi i punimeve.

Konkretisht kemi :

2.490/h	F.V. Kasete plastike KE me 54 modular (vende)
2.490/f	F.V. Kasete plastike KE me 36 modular (vende)
2.535	F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A
2.490/1e	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A
2.537	F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;40A
2.490/1	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A
2.490/1b	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A
2.530	F.V. Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V
2.490/1a	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A
2.473	F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40
2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm
2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm

2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm
2.485/d	F.V. Priza shuko universal
2.485/1	F.V. Çeles 1 polar 220V 10A
2.485/4	F.V. Çeles 2 polar 220V 10A
2.480/5	F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm
2.480/3	F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm
2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm
2.481/5	F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm ²
2.481/4	F.V. Percjelles PV-500 Ø 6 mm ²
2.481/3	F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm ²
2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm ²
2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm ²
2.561	F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w
2.503	F.V. Percjelles shirit Zn 30x3mm
2.500	F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm ² , i zhveshur
2.483	F.V. Çelesa e priza 10 A (per internetin)
4.149/7	F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome per ndricim, ne tubot e vendosur me pare, sexion 16mm ²
4.131/3.9	F.V. Ne toke kabllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 3x50+25mm ²
3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xingura 50x3mm L=150cm (mbrojtja atmosferike)
An	F.V Ndriçues LED panel, 60 × 60 cm, 40 W
An	F.V. Ndriçues LED plafon rrethor për montim në mur, 18 W, IP44

An	Automat magneto-termik 380V,25A, 4P
An	F.V. Tub plastmasi Ø 63
An	Kabell P.V.C. 3x1,5mm ²
An	F.V. Regjistrues video në rrjet (NVR) 16 kanale IP me 16 porta PoE, në përputhje me EN 50130-4
An	Hard Disk SATA II, 1 TB
An	Kabëll koaksial (Video) RG59 + 2 × 0.50 mm ² , 75 Ω
An	F.V Switch Gigabit i menaxhueshëm me 16 porta PoE, 1 portë RJ45 dhe 1 portë SFP, në përputhje me EN 50130-4
An	Kabëll fibër optike
An	Kabëll rrjeti UTP Cat.6
An	F.V. Kamerë e brendshme IP tip Dome, 4 MP, PoE, kompresim H.265+, mbrojtje IP67, në përputhje me EN 50130-4
An	F.V Kamerë e jashtme IP tip Bullet, 4 MP, PoE, kompresim H.265+, True WDR 120 dB, rreze efektive e ndriçimit IR deri në 30 m, mbrojtje IP67, në përputhje me EN 50130-4
An	F.V. Terminal kontrolli aksesit, me tastierë numerike, lexues karte, portë rrjeti RJ-45, PoE, RS-485, Wiegand, mbrojtje IP65 dhe IK09, në përputhje me EN 50130-4
An	F.V Ndriçues LED panel, 60 × 60 cm, 40 W
An	F.V. Ndriçues LED plafon rrethor për montim në mur, 18 W, IP44
An	Automat magneto-termik 380V,25A, 4P
An	F.V. Tub plastmasi Ø 63
An	Kabell P.V.C. 3x1,5mm ²

An	F.V. Regjistrues video në rrjet (NVR) 16 kanale IP me 16 porta PoE, në përputhje me EN 50130-4
An	Hard Disk SATA II, 1 TB
An	Kabëll koaksial (Video) RG59 + 2 × 0.50 mm ² , 75 Ω
An	F.V Switch Gigabit i menaxhueshëm me 16 porta PoE, 1 portë RJ45 dhe 1 portë SFP, në përputhje me EN 50130-4
An	Kabëll fibër optike
An	F.V. Kabell elektrik bakri FROR 3x1.5
An	F.V. Kuti derivacioni plastike
An	F.V.Tub plastmasi Ø14-17mm
An	F.V.Tub plastmasi Ø18-21mm
An	F.V. Panel kontrolli adresues për sistemin e alarmit të zjarrit, 2 qarqe (loops), në përputhje me EN 54-2
An	F.V. Sirenë alarmi e brendshme, e adresueshme, në përputhje me EN 54-3
An	F.V. Sirene alarmi jashte nderteses e adresueshme, në përputhje me EN 54-3
An	F.V.Buton manual alarmi i adresueshëm me izolator të integruar, në përputhje me EN 54-11 dhe EN 54-17
An	Kapese mesore per kapjen e panelit (35mm)
An	Kapese fundore per kapjen e panelit (35mm)
An	Shina alumini per mbajtjen e moduleve
An	Aksesor alumini per mbajtjen e shinave nen cati
An	Aksesor alumini per bashkimin shinave nen

	cati
An	Kabell fotovoltaiK H1Z2Z2 6 mm /i kuq
An	Kabell fotovoltaiK H1Z2Z2 6 mm / i zi
An	Konektore per kabell fotovoltaiK MC4 EVO2 TS4 Male
An	Konektore per kabell fotovoltaiK MC4 EVO2 TS4 Female
An	Percjelles tokezimi 6mm ² verdh/jeshil
An	Percielles AC 3*70+2*50mm ²
An	kapikorda 70 mm M12
An	kapikorda 50 mm M12
An	Kapikorda me veshje per percjelles 6mm ² me fi 8
An	Bulona=Dado Per tokzimin
An	Tub Guain 20
An	Tub Guain 25
An	Tub Guain 32
An	Vida metalike autofiletante me gomine 6.3x25
An	Vida egagonale 5x60 + Upa plastike universale UX8x40 mm
An	Rondele M10
An	Shirit metalik I vrimezuar
An	Izolant
An	Fasheta plastike 4x250 outdoor

An	Fasheta plastike 4x350 outdoor
An	Aksesor dhe materiale ndihmese

Nga një përlogaritje e thjeshtë vërehet se;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 1976 orë pune në total për 9 muaj e 2 jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

7818.92orë pune (për punimet elektrike): 1976 orë totali në 9 muaj e 2 jave = 3.95 punonjës elektriciçist të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 9 muaj e 2 jave.

Duke qënë se punimet elektrike do të kryhen brenda muajit te 2 deri në 11 muaj (sipas parashikimit të autoritetit kontraktor) njësia e prokurimit gjykon se këto punime mund të ecin paralelisht me punimet e tjera dhe mund të shtrihen në kohë, duke përgjysmuar numrin e nevojshëm të punonjësve elektrik si dhe duke iu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomik ofertues në përmbushje të kriterit të mësipërm.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se pesë punonjës janë të mjaftueshëm për punime elektrike, duke përcaktuar 1 teknik të mesëm elektrik të pajisur me diplome te shkolles se mesme si dhe 4 elektriciçist të pajisur me dëshmi profesionale ose certifikat trajnimi.

Hidraulike 2 (dy) persona janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve hidraulike, sipas zërave të preventivave të punimeve. Duke marrë në konsideratë faktin se punimet për sistemin hidraulike do të fillojne te kryhen në muajin e dyte (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish hidraulik.Konkretisht, vetëm për punime hidraulike janë parashikuar 1454.15ore pune nga zërat e per te vazhduar me tej tek analizat jashte liste tek preventivi i punimeve.

Konkretisht kemi:

2.615	Heqje pajisje hidrosanitare
2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16
2.230	F.V. Tuba e rakorderi PPR Pn 16 f= 50 mm
2.535/d	Termoizolim tubi Ø 11/4" me armofleks (d42x9)

2.535/f	Termoizolim tubi Ø 1 1/2" me armofleks (d54x9)
2.494/4	F.V. Saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm
2.504	F.V. WC allaturka
2.501	F.V. WC allafrenga
2.495	F.V. Lavaman porcelani
2.515	F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50
2.228	F.V. Tuba e rakorderi PPR Pn 20 f = 63 x 6.4 mm
2.230	F.V. Tuba e rakorderi PPR Pn 16 f = 50 mm
2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16
2.491/c	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16
2.491/b	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16
2.535/g	Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)
2.535/f	Termoizolim tubi Ø 1 1/2" me armofleks (d54x9)
2.535/d	Termoizolim tubi Ø 1 1/4" me armofleks (d42x9)
2.535/c	Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)
2.535/b	Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)
2.494/b	F.V. Tuba bakri e rakorderi d = 18x1 mm
2.228	F.V. Tuba e rakorderi PPR Pn 20 f = 63 x 6.4 mm
2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16
2.491/c	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16
2.491/b	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16
2.535/g	Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)

2.535/d	Termoizolim tubi Ø 1 1/4" me armofleks (d42x9)
2.535/c	Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)
2.535/b	Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)
2.512/4	F.V. Kolektor shpendares 1" (6+6)
2.215	F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte
An	F.V.Tubo PE-HD Ø63 X5.8mm
An	F.V. Tubo PEX/al,DN 12 (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar $\delta=6$ mm
An	F.V. Rakorderi per montim tubash (brryla, tee, reduksion, etj)
An	F.V. Rakorderi per mberthim tubosh
An	F.V. Elemente mberthyes e fiksues (Upa metalik, Prixhonier, Luktide, fasheta, shirit, gozhde, shkume)
An	F.V. Mini saracineska M/M 1/2 - 1/2
An	F.V. Elemente mberthyes e fiksues
An	F.V. Valvol moskthimi DN 50 (Ø2") Pn 16 bar
An	F.V. Filter DN 50, Ø 2 "
An	F.V. Reduktor presioni Ø 2"
An	F.V. Xhunto antivibruese DN 50 Ø 2"
An	F.V. Elemente plotsues per instalimet e linjave hidraulike (Niple, Manikota, Hollandez, Fije lini, Paste, Loctide leng, etj)"
An	F.V. Tubo shkarkimi PP d110
An	F.V. Tubo shkarkimi PP d75
An	F.V. Tubo shkarkimi PP d50
An	F.V. Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)

An	F.V. Tubo shkarkimi PP d170
An	F.V. Tubo shkarkimi PP d125
An	F.V. Tubo shkarkimi PP d110
An	F.V. Tubo shkarkimi PP d75
An	F.V. VENTILATOR 110 m³/h, Fe - 20 W
An	F.V. Grile ventilimi
An	F. Tubo PEX/al,DN 12 (Ø16x2)mm,termoizoluar δ=6mm
An	Rakorderi mberthimi (Ti, bryla..etj)
An	Kapse tubosh ne dysHEME dhe ne mure
An	F.Valvol nderprerese radiator me sfere ½"
An	F.Valvola ajernxjerrese ½"
An	F.Elemente fiksues ne mur

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 780 orë pune në total për 3 muaj e 3 jave, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

1454.15 ore pune (për punimet hidraulike): 780 orë totali në 3 muaj e 3 jave = 1.86 punonjës hidraulike të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 3 muaj e 3 jave.

Duke qënë se punimet hidraulike do të kryhen brenda muajit te 2 deri në 10 muaj (sipas parashikimit të autoritetit kontraktor) njësia e prokurimit gjykon se këto punime mund të ecin paralelisht me punimet e tjera dhe mund të shtrihen në kohë, duke përgjysmuar numrin e nevojshëm të punonjësve hidraulik si dhe duke iu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomik ofertues në përmbushje të kriterit të mësipërm.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se 2 punonjës janë të mjaftueshëm për punime hidraulike, duke përcaktuar 2 hidraulike të pajisur me dëshmi profesionale ose certifikat trajnimi.

Specialiste për sisteme ngrohje-ftohje 2 (dy) janë të nevojshëm pasi punimet e sistemit të ngrohjes zënë një pjesë të konsiderueshme në zërat e preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë se punimet për sistemin ngrohje-ftohje do të kryhen përgjate 4 muaj, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë për sisteme ngrohje-ftohje. Konkretisht, vetëm punime ngrohje janë parashikuar **2741.89** orë punë nga zërat e Punime hidro-sanitare dhe ngrohje tek preventivi i punimeve. Akoma më tej kemi dhe punimet për pajisjet si më poshtë dhe montimi i tyre :

2.494/b	F.V. Tuba bakri e rakorderi d = 18x1 mm
2.228	F.V. Tuba e rakorderi PPR Pn 20 f = 63 x 6.4 mm
2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16
2.491/c	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16
2.491/b	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16
2.535/g	Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)
2.535/d	Termoizolim tubi Ø 1 1/4" me armofleks (d42x9)
2.535/c	Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)
2.535/b	Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)
2.512/4	F.V. Kolektor shpendares 1" (6+6)
An	F.V. Tubo PEX/al, DN 12 (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar δ= 6mm
An	Rakorderi mberthimi (Ti, bryla..etj)
An	Kapse tubosh ne dysHEME dhe ne mure
An	F.Valvol nderprerese radiator me sHERE

	½"
An	F.Valvola ajernxjerrese ½"
An	F.Elemente fiksues ne mur
An	F.V. Kanal I tymrave me llamarine d=100mm .
An	V. Njesi e Brendshme Kasete Fuqia nominale Ftohese/Ngrohese: 3.6 / 4.0 kW Tensioni: 1/220-230/50/60 Ph/V/Hz Dimensionet: 570x570x260 mm Lidhjet: Ø6.35 / Ø12.7(per godinen ekzistuese)
